

UNMIK RREG/2001/33
15 nëntor 2001

RREGULLORE NR. 2001/33
MBI ZGJEDHJET E KUVENDIT TË KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me pushtetin që i është dhënë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor të vitit 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/21, të ndryshuar, të datës 18 prill të vitit 2000 mbi Themelimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2001/12 të datës 31 korrik të vitit 2000 mbi zbatimin e Rregullores nr. 2000/13 të UNMIK-ut mbi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

Duke pasur parasysh dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj të vitit 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë ("Korniza Kushtetuese"),

Me qëllim të përcaktimit të dispozitave themelore që rregullojnë zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës,

Me këtë shpall sa vijon:

Neni 1
Përkufizimi

Sipas kësaj Rregulloreje, "subjekt politik" do të thotë parti politike, koalicion, iniciativë e qytetarëve ose kandidat i pavarur.

Neni 2
Data e zgjedhjeve

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të caktojë dhe do të shpallë datat e zgjedhjeve për Kuvendin.

Neni 3
Certifikimi i procesit të regjistrimit dhe rezultatet e zgjedhjeve

3.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ka autoritetin për të certifikuar formimin e listës së votuesve në pajtim me rregulloret dhe urdhëresat administrative në fuqi pas rekomandimit të drejtorit për Çështje zgjedhore, funksioni i të cilit është definuar me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2001/12.

3.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të urdhërojë numërimin e sërishëm të votave në çdo qendër të numërimit të votave dhe gjithashtu mund të urdhërojë edhe përsëritjen e zgjedhjeve në ndonjë vendvotim apo në të gjitha vendvotimet.

3.3 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ka autoritetin për t'i certifikuar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në bazë të rekomandimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të rekomandojë lidhur me certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve pas përfundimit të të gjitha procedurave në qendrat e votimit dhe qendrat e numërimit dhe atëherë kur ankesat rreth votimit dhe numërimit të jenë shpallur nga nënkomisioni për parashtresa dhe ankesa zgjedhore.

3.4 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i publikon rezultatet përfundimtare pas certifikimit të tyre nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 4
Ndarja e vendeve

4.1 Një votues mund të votojë vetëm për një subjekt politik në fletëvotim.

4.2 Vendet në Kuvend do të ndahen sipas sistemit të përfaqësimit, të përcaktuar me paragrafin 9.1.3 të Kornizës Kushtetuese, do të thotë duke caktuar:

(a) Njëqind (100) vende ndërmjet të gjitha subjekteve të certifikuara politike në proporcion me numrin e votave të vlefshme të fituara nga ata dhe

(b) Njëzet (20) vende të rezervuara për përfaqësimin plotësues të komuniteteve, sipas mënyrës së specifikuar në Kornizën Kushtetuese.

4.3 Ndarja e vendeve për subjektet politike bëhet si më poshtë:

(a) Numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të fituara nga çdo subjekt politik që konkurren për një numër vendesh, sipas mënyrës së përcaktuar në paragrafin 9.1.3(a)-(b) të Kornizës Kushtetuese, pjestohet me 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, *e kështu me radhë* derisa numri pjestuesve të përdorur të korrespondojë me numrin e përgjithshëm të vendeve që do të jepen për atë grup vendesh;

(b) Koeficientët e fituar prej këtyre radhëve të ndarjeve renditen prej më të madhit deri te më i vogli. Vendet u ndahen subjekteve politike në bazë të koeficientëve; vendi i parë i

takon subjektit me koeficientin më të madh, vendi i dytë subjektit me koeficientin e dytë më të madh, *e kështu me radhë* derisa të jenë ndarë të gjitha vendet në atë grup;

(c) Vendet së pari do të ndahen në grupin prej njëqind vendeve të përcaktuara në paragrafin 9.1.3(a) të Kornizës Kushtetuese dhe pas kësaj grupet e vendeve të rezervuara për përfaqësimin plotësues të komuniteteve joshqiptare të Kosovës siç është përcaktuar në paragrafin 9.1.3(b) të Kornizës Kushtetuese sipas këtij rendi: Komunitetit serb të Kosovës dhjetë (10) vende, komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian katër (4) vende, komunitetit boshnjak tri (3) vende, komunitetit turk dy (2) vende dhe komunitetit goran një (1) vend;

(ç) Çfarëdo koeficienti përmes të cilit një subjekt politik e fiton një vend në kuadër të vendeve ekzistuese nuk do të merret parasysh në çfarëdo ndarjeje të mëtejme të vendeve.

(d) Nëse një subjekti politik i janë ndarë vende në prporcion me numrin e kandidatëve në listën e tij dhe kanë mbetur ende vende për t'u ndarë, atëherë koeficientët e mbetur të atij subjekti nuk do merren parasysh gjatë ndarjes së vendeve të mbetura dhe

(dh) Vendet që i janë ndarë një subjekti politik në cilindo grup duhet të mblidhen në mënyrë që të fitohet numri i përgjithshëm i vendeve që i ka fituar subjekti politik. Ky numër përbën numrin e tërësishëm të vendeve të ndara për atë subjekt politik me qëllim të zgjedhjes për shpërndarjen e kandidatëve të tij.

4.4 Nëse ndodh barazimi për shkak se koeficientët janë të njëjtë, vendi ndahet me tërheqje të shortit nga ndonjë anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në prani të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve politike përkatëse.

4.5 Numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për një subjekt politik në përfundimin e procedurës së përcaktuar në nenin 4.3 (f) do t'u shpërndahet kandidatëve të saj, duke filluar nga kandidati i parë në listën e atij subjekti politik dhe vazhdon derisa të gjithë kandidatët t'i kenë marrë vendet që i janë ndarë atij subjekti politik.

4.6 Aty ku nuk mund të zbatohet formula e përfaqësimit proporcional e përcaktuar në nenin 4.3, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në konsultim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve do të vendosë për mënyrën e ndarjes së vendeve.

4.7 Një shembull i formulës zgjedhore të përcaktuar në nenin 4.3 është paraqitur në Shtojcën që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje. Shtojca shërben vetëm si informatë. Nëse ndodh kundërtënia në mes Shtojcës dhe nenit 4, atëherë vlejné dispozitat e nenit 4.

4.8 Vendet e ndara në përputhje me këtë Rregullore u takojné personalisht kandidatëve të zgjedhur e jo subjektit politik. Nëse ndodh të lirohet një vend, Kryetari i Kuvendit i bën një kërkesë me shkrim Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për plotësimin e atij vendi. Një kërkesë e tillë duhet të sqarojë se si ka ardhur deri të lirimi i atij vendi. Në këtë rast Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të kërkojë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të paraqesë një propozim për plotësimin e vendit të liruuar, duke dhënë emrin e personit të përshtatshëm në radhë të të njëjtes gjini me personin i cili e ka liruuar vendin në listën e subjektit politik përkatës.

Neni 5
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 6
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 nëntor 2001.

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

SHTOJCË

Shembulli i formulës zgjedhore i detajuar në nenin 4 të Rregullorës së UNMIK-ut mbi zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës:

Për një Kuvend ku duhet të ndahen 100 vende janë vërtetuar 8 subjekte politike: 4 parti politike, 2 koalicione, një iniciativë qytetare dhe një kandidat i pavarur. Çdo parti politike dhe koalicion, përveç partisë D, kanë nga 100 kandidatë në listën e tyre të kandidatëve. Partia D ka vetëm 5 kandidatë në listën e kandidatëve. Kandidati i pavarur E, sipas definimit, ka vetëm një kandidat dhe iniciativa qytetare CI-H ka vetëm 4 kandidatë në listën e kandidatëve.

Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme është 558.522. Koalicioni A fiton 105.918 vota, Koalicioni B fiton 6.523 vota, Partia C fiton 215.678 vota, Partia D fiton 124.746 vota, Kandidati i pavarur E fiton 66.587 vota, Partia F fiton 21.379 vota, Partia G fiton 3.870 dhe Iniciativa qytetare H fiton 13.821 vota. Ndarja e 100 vendeve bëhet sipas serisë mbi ndarjet në vijim, pjesëtuesit janë të cekur në shtyllën e majtë

Tabela e ndarjes së vendeve

	CL-A	CL-B	PT-C	PT-D	IC-E	PT-F	PT-G	CI-H
1	105,918.0	6,523.0	215,678.0	124,746.0	66,587.0	21,379.0	3,870.0	13,821.0
3	35306.0	2174.3	71892.7	41582.0	22195.7	7126.3	1290.0	4607.0
5	21183.6	1304.6	43135.6	24949.2	13317.4	4275.8	774.0	2764.2
7	15131.1	931.9	30811.1	17820.9	9512.4	3054.1	552.9	1974.4
9	11768.7	724.8	23964.2	13860.7	7398.6	2375.4	430.0	1535.7
11	9628.9	593.0	19607.1	11340.5	6053.4	1943.5	351.8	1256.5
13	8147.5	501.8	16590.6	9595.8	5122.1	1644.5	297.7	1063.2
15	7061.2	434.9	14378.5	8316.4	4439.1	1425.3	258.0	921.4
17	6230.5	383.7	12686.9	7338.0	3916.9	1257.6	227.6	813.0
19	5574.6	343.3	11351.5	6565.6	3504.6	1125.2	203.7	727.4
21	5043.7	310.6	10270.4	5940.3	3170.8	1018.0	184.3	658.1
23	4605.1	283.6	9377.3	5423.7	2895.1	929.5	168.3	600.9
25	4236.7	260.9	8627.1	4989.8	2663.5	855.2	154.8	552.8
27	3922.9	241.6	7988.1	4620.2	2466.2	791.8	143.3	511.9
29	3652.3	224.9	7437.2	4301.6	2296.1	737.2	133.4	476.6
31	3416.7	210.4	6957.4	4024.1	2148.0	689.6	124.8	445.8
33	3209.6	197.7	6535.7	3780.2	2017.8	647.8	117.3	418.8
35	3026.2	186.4	6162.2	3564.2	1902.5	610.8	110.6	394.9
37	2862.6	176.3	5829.1	3371.5	1799.6	577.8	104.6	373.5
39	2715.8	167.3	5530.2	3198.6	1707.4	548.2	99.2	354.4
41	2583.4	159.1	5260.4	3042.6	1624.1	521.4	94.4	337.1
43	2463.2	151.7	5015.8	2901.1	1548.5	497.2	90.0	321.4
45	2353.7	145.0	4792.8	2772.1	1479.7	475.1	86.0	307.1
47	2253.6	138.8	4588.9	2654.2	1416.7	454.9	82.3	294.1
49	2161.6	133.1	4401.6	2545.8	1358.9	436.3	79.0	282.1
51	2076.8	127.9	4229.0	2446.0	1305.6	419.2	75.9	271.0
53	1998.5	123.1	4069.4	2353.7	1256.4	403.4	73.0	260.8
55	1925.8	118.6	3921.4	2268.1	1210.7	388.7	70.4	251.3
57	1858.2	114.4	3783.8	2188.5	1168.2	375.1	67.9	242.5
59	1795.2	110.6	3655.6	2114.3	1128.6	362.4	65.6	234.3
61	1736.4	106.9	3535.7	2045.0	1091.6	350.5	63.4	226.6
63	1681.2	103.5	3423.5	1980.1	1056.9	339.3	61.4	219.4
65	1629.5	100.4	3318.1	1919.2	1024.4	328.9	59.5	212.6
67	1580.9	97.4	3219.1	1861.9	993.8	319.1	57.8	206.3
69	1535.0	94.5	3125.8	1807.9	965.0	309.8	56.1	200.3
71	1491.8	91.9	3037.7	1757.0	937.8	301.1	54.5	194.7
73	1450.9	89.4	2954.5	1708.8	912.2	292.9	53.0	189.3
75	1412.2	87.0	2875.7	1663.3	887.8	285.1	51.6	184.3
77	1375.6	84.7	2801.0	1620.1	864.8	277.6	50.3	179.5

79	1340.7	82.6	2730.1	1579.1	842.9	270.6	49.0	174.9
81	1307.6	80.5	2662.7	1540.1	822.1	263.9	47.8	170.6
83	1276.1	78.6	2598.5	1503.0	802.3	257.6	46.6	166.5
85	1246.1	76.7	2537.4	1467.6	783.4	251.5	45.5	162.6
87	1217.4	75.0	2479.1	1433.9	765.4	245.7	44.5	158.9
89	1190.1	73.3	2423.3	1401.6	748.2	240.2	43.5	155.3
91	1163.9	71.7	2370.1	1370.8	731.7	234.9	42.5	151.9
93	1138.9	70.1	2319.1	1341.4	716.0	229.9	41.6	148.6
95	1114.9	68.7	2270.3	1313.1	700.9	225.0	40.7	145.5
97	1091.9	67.2	2223.5	1286.0	686.5	220.4	39.9	142.5
99	1069.9	65.9	2178.6	1260.1	672.6	215.9	39.1	139.6
101	1048.7	64.6	2135.4	1235.1	659.3	211.7	38.3	136.8
103	1028.3	63.3	2094.0	1211.1	646.5	207.6	37.6	134.2
105	1008.7	62.1	2054.1	1188.1	634.2	203.6	36.9	131.6
107	989.9	61.0	2015.7	1165.9	622.3	199.8	36.2	129.2
109	971.7	59.8	1978.7	1144.5	610.9	196.1	35.5	126.8
111	954.2	58.8	1943.0	1123.8	599.9	192.6	34.9	124.5
113	937.3	57.7	1908.7	1103.9	589.3	189.2	34.2	122.3
115	921.0	56.7	1875.5	1084.7	579.0	185.9	33.7	120.2
Vendet	27	2	54	5	1	6	1	4

Të 100 koeficientët më të lartë përkatës lëvizin prej 215.678 deri 1.943,5 dhe janë theksuar në tabelën e mësipërme. Këta koeficientë janë bazuar në atë se Kandidati i pavarur E mund të fitojë vetëm një vend dhe Partia D ka vetëm pesë kandidatë në listën e saj. Prandaj, pas ndarjes së një vendi kandidatit E bazuar në koeficientin e tij/saj të parë (66.587), koeficientet e mbetura nuk mirren parasysh. Njësoj, pas ndarjes së pesë vendeve Partisë D për pesë kandidatët në listën e saj (bazuar në kursin: 124.746; 41.582; 24.949; 17.820; dhe 13.860), koeficientet vijuese të Partisë D nuk janë marrë në konsideratë.

Ndarja definitive e vendeve për secilin entitet është cekur në fund të tabelës. Numri i përgjithshëm është 100.